



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Nr. _____ Prot.

Tiranë më ____ . ____ . _____

Proces-verbal

**Përfaqësuesit e Shoqërisë Civile
Këshilli Kombëtar i Shoqërisë Civile**

I mbajtur sot më datë 01.03.2017 në orën 10:00 në ambientet e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile.

Të pranishëm konfirmohen anëtarët si më poshtë - përfaqësues të Shoqërisë Civile pranë Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile:

1. Z. Altin Hazizaj;
2. Z. Ali Coka;
3. Znj. Erisa Lame;
4. Z. Luan Ahmetaj;
5. Znj. Mirela Koçi;
6. Z. Ergys Gezka;
7. Znj. Iris Luarasi

Nga ana e Sekretariatit Teknik, të pranishëm janë:

1. Z. Andi Kananaj- Drejtor Ekzekutiv;
2. Znj. Mikela Kakeli;
3. Znj. Yllka Demollari;
4. Z. Ferhat Aga;
5. Z. Erion Banushi;
6. Znj. Ermela Bektic

Nisja e mbledhjes inicoi me hedhjen e shortit i cili u realizua përmes ndarjes në 2 (dy) kutia të emrave të anëtarëve të shoqërisë civile pranë K.K.Sh.C-së dhe mandateve përkatëse të cilat në fund u ndanë si më poshtë:

- | | | |
|------------------------|---|------------------|
| 1. Z. Altin Hazizaj | - | Mandat 1 vjeçar; |
| 2. Znj. Mirela Koçi | - | Mandat 1 vjeçar; |
| 3. Znj. Migena Shulla | - | Mandat 1 vjeçar; |
| 4. Znj. Artemisi Shehu | - | Mandat 1 vjeçar; |
| 5. Znj. Emanuela Zaimi | - | Mandat 2 vjeçar; |
| 6. Znj. Iris Luarasi | - | Mandat 2 vjeçar; |
| 7. Z. Ali Coka | - | Mandat 2 vjeçar |
| 8. Znj. Erisa Lame | - | Mandat 2 vjeçar |
| 9. Z. Luan Ahmetaj | - | Mandat 3 vjeçar |
| 10. Znj. Zana Vokopola | - | Mandat 3 vjeçar |
| 11. Z. Ergys Gezka | - | Mandat 3 vjeçar |
| 12. Z. Blendi Dibra | - | Mandat 3 vjeçar |
| 13. Z. Vladimir Thanu | - | Mandat 3 vjeçar |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Pas këtij momenti, fjalën e hapjes e mori z. Hazizaj i cili shprehu interesin mbi përgatitjen për planin strategjik i cili mund të realizohet edhe përmes një udhëtimit studimor që në rastin më të mirë do të ishte qyteti i Brukselit ose në një tjetër qytet si në Poloni.

Drejtori Ekzekutiv i AMShC-së shprehu idenë e tij se edhe Sllovakia ka një Këshill të ngjashëm dhe në fund u shpreh që kjo iniciativë t'u propozohet edhe anëtarëve të tjerë të Këshillit dhe ato të vendosin. Për këtë propozim, do t'u dërdërgohet e-mail anëtarëve.

Z. Hazizaj gjithashtu u shpreh se propozon të krijohen tre komitete për secilën fushë të mbuluar nga Këshilli dhe një të katërt për t'u angazhuar lidhur me mandatet.

Drejtori Ekzekutiv u shpreh se mendon të krijojë grupe pune për t'u angazhuar me çështjen e taksave.

Znj. Koçi e mbështeti këtë propozim duke u shprehur edhe për trajtimin e anës fiskale nga Drejtoria e Tatimeve dhe për këtë përmendi rastin e biznesit i cili u angazhua tepër deri në faljen totale të borxheve tatimore.

Z. Hazizaj u shpreh se kjo ishte edhe arsyeja e cila e shtyu të propozonte krijim të grupeve të punës dhe u vetëpropozua për drejtues i njërit prej grupeve.

Znj. Zaimi u shpreh se grupet duhen krijuar sipas specifikës të gjithësecilit pasi unë propozoj krijim të grupit edhe për pjesën e shoqërisë civile për ofrimin e shërbimeve ku pagesën e energjisë elektrike e llogarisin si biznes.

Z. Gezka u shpreh lidhur me zgjerimin e planin strategjik me propozim që Këshilli të realizojë dëgjesa publike në mënyrë që të renditen prioritetet ndihmëse për këtë plan.

Z. Hazizaj propozoi që deri ditën e premtë:

1. Të dërgohen mendime lidhur me strategjinë, konsultimet publike dhe dëgjesat;
2. Të krijohen tre grupe pune/ komitete sipas ligjit dhe dy të tjera ku njëra do të shërbejë për mandatet dhe tjetra për komunikimin mediatik

Z. Gezka u shpreh për transparencë të veprimitarisë së Këshillit duke pasqyruar emrat dhe kontaktet e secilit anëtar.

Z. Ahmetaj propozoi që mbledhjet e Këshillit të realizohen në prani të medias pasi kjo mënyrë rrit transparencën.

Më tej, mbledhja e Këshillit vijoi me fjalën e z. Ahmetaj i cili citoi faktin e zëvendëskryetarit duke u shprehur nëse bien dakord që t'i propozojmë Këshillit mbi vendosjen e disa kritereve për këtë përzgjedhje edhe pse ato na e kanë lënë neve në dorë përzgjedhjen e një emri.

Në këtë moment u krijua ambienti i debatit lidhur me kriteret e nevojshme ku u përmendën gjuha e huaj (anglisht), eksperiencë mbi pesë vjeçare në ekspertizë dhe komunikimi i nevojshëm.

Mbledhja u mbyll në orën 12:30.